AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I

"KUMONETIC" SHPK

Sot, më 09.10.2025, Znj. Jona Bojdani, shtetase shqiptare, lindur më 25.03.1998, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 039532111 dhe nr. Personal. J85325051U, në cilësinë e Ortakes së Vetme, nëpërmjet këtij dokumenti themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe këtë Akt.

KREU I

EMËRTIMI-SELIA-OBJEKTI-KOHËZGJATJA

Neni 1

Emërtimi i Shoqërisë

Ky Akt (këtu e në vijim referuar si "**Statuti**") rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar si "**KUMONETIC**" **Shpk** (këtu e në vijim referuar si "**Shoqëria**").

Neni 2

Forma juridike

"KUMONETIC" Shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në veçanti me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, Datë 14.04.2008 "*Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare*", i ndryshuar (këtu e në vijim referuar si "**Ligji i Shoqërive Tregtare**"), dhe në përputhje me këtë Statut.

Neni 3
Selia ligjore e Shoqërisë

3.1 Selia ligjore e Shoqërisë do të jetë në adresën: "**Durana Tech Park, Rruga Ahmet Zogu, nr. pasurisë 336, ZK 3852, njësia administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak, kodi postar 2013**".

3.2 Shoqëria nëpërmjet Administratorëve/it të saj mund të hapë dhe/ose mbyllë filiale, degë, agjenci dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja

4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë tregtare për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohet me vendim të Ortakut të Vetëm, sipas dispozitave të këtij dokumenti dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 5
Objekti i Veprimtarisë

5.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë si vijon:

- Zhvillim dhe tregtim produktesh dhe shërbimesh në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit digjital, përfshirë software, cloud, fintech, inteligjencë artificiale, siguri kibernetike, zgjidhje fiskale dhe teknologji për sektorë të ndryshëm, përfshirë shëndetësinë dhe financat, si dhe konsulencë dhe trajnime në fushat përkatëse.

5.2 Shoqëria mund të ndryshojë objektin e saj të aktivitetit në çdo kohë, në perputhje me dispozitat e legjislacionit të zbatueshëm në fuqi, si dhe këtë Akt.

5.3 Shoqëria, me qëllim të investimit të kapitalit të saj, mund të zotërojë interesa dhe të marrë pjesë në shoqëri të tjera, konsorciume, etj., që kanë objekt veprimtarie të çdo lloji, të ngjashme ose të lidhura me veprimtarinë e saj.

5.4 Pavarësisht nga sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të dobishme ose të nevojshme të lejuar me ligj për realizimin e objektit të saj të veprimtarisë.

KREU II
KAPITALI DHE KUOTAT

Neni 6

Kapitali

6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000.00 (njëqind mijë) Lekë.

6.2 Kapitali themeltar i nënshkruar i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, në përputhje me nenin 7 më poshtë.

6.3 Shlyerja e kapitalit të Shoqërisë do të kryhet pas fitimit të personalitetit juridik të saj, sipas vendimit të organeve të administrimit të Shoqërisë.

Neni 7
Ortaku i Vetëm

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është:

- Znj. Jona Bojdani, shtetase shqiptare, lindur më 25.03.1998, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 039532111 dhe nr. Personal. J85325051U, **zotëruese e 1 (një) kuote që korrespondon me 100% të kapitalit të Shoqërisë,** ekuivalent me 100,000.00 (njëqind mijë) Lekë.

Neni 8

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

8.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet në çdo kohë, në një ose më shumë këste, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vendim të Ortakut të Vetëm sipas parashikimeve në këtë dokument.

8.2 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin, me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapitali nuk mund të zvogëlohet nën 100 Lekë *(njëqind)*, që është minimumi i vlerës së kapitalit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 9
Transferimi i Kuotave

9.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë në çdo kohë për pjesëtimin dhe transferimin e kuotave përmes shitjes, dhurimit, transferimit me rrug trashëgimie apo ndonjë mënyre tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

9.2 Në rastet kur kuotat transferohen nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi, Ortakut të Vetëm i jepet e drejta për të specifikuar kushtet, momentin e kalimit të titullit të pronësisë, dhe momentin e shlyerjes së çmimit të rënë dakord.

KREU III

ORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 10

Organet e Shoqërisë

10.1 Organet e Shoqërisë janë si vijon:

- Ortaku i Vetëm – organi më i lartë vendimmarrës;
- Administratori/ët – organi më i lartë ekzekutiv.

10.2 Ortaku i Vetëm është përgjegjës, *ndër të tjera*, për vendimet në lidhje me sa vijon:

i. përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë;

ii. ndryshimin e Stauttit;

iii. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, auditorëve dhe likuiduesve si dhe shpërblimin e tyre;

iv. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët;

v. zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë,

vi. transferimn e kuotave;

vii. shpërndarjen e dividentit;

viii. riorganizimin dhe/ose shpërbërjen e Shoqërisë; dhe çdo çështje tjetër të përcaktuar nga legjislacionin në fuqi dhe ky Statut.

Neni 11
Regjistri i Vendimeve

11.1 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

11.2 Duhet të regjistrohen në veçanti, vendimet për:

a) miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c) investimet;

d) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

11.3 Lista e mësipërme nuk është shteruese dhe vendimet të cilat nuk regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, do të konsiderohen të pavlefshme.

Neni 12
Administrimi

12.1 Shoqëria mund të administrohet nga një apo disa administratorë, numri dhe kompetencat e të cilëve do të përcaktohen me vendim të Ortakut të Vetëm.

Administratori i Shoqërisë do të jetë:

- ***Z. Klajdi Poshnjari**, shtetas shqiptar, lindur më 03.11.1996, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 039999020 dhe nr. Personal J61103050B*

Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar.

12.2 Administratori/ët emërohen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me vendim të të njëjtit.

12.3 Administratori/ët do të jenë persona fizikë, pa asnjë kufizim në lidhje me shtetësinë. Afati i mandatit të Administratorëve do të vendoset në momentin e emërimit, por në çdo rast nuk mund të kalojë 5 (pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritje.

Neni 13
Kompetencat e Administratorit

13.1 Administratori/ët janë përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqësojnë Shoqërinë tek palët e treta, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin në fuqi.

13.2 Kompetencat dhe detyrat e administratorit/ve në lidhje me adminstrimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijnë, por pa u kufizuar, si vijon:

i. zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe vendimet e Ortakut të Vetëm;

ii. të sigurojnë pajtueshmërinë e Shoqërisë me ligjet dhe standardet e kontabilitetit;

iii. të kryejnë të gjitha veprimet lidhur me administrimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;

iv. të sigurojnë mirëmbajtjen e rregullt të dokumenteve financiare dhe kontabël të Shoqërisë;

v. të përfaqësojnë Shoqërinë tek palët e treta;

vi. të kryejnë të gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme në lidhje me Shoqërinë siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi;

vii. të kryejnë detyra të tjera të parashikuara nga ligji dhe nga ky dokument.

13.3 Administratori/ët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj dhe me këtë dokument janë të rezervuara për Ortakun e Vetëm ose janë të kufizuara nga ky dokument ose ligji në fuqi.

13.4 Administratori/ët mund t'u delegojnë një pjesë ose të gjitha kompetencat e tyre personave të tjerë.

13.5 Ortaku i Vetëm përcakton, me vendim të duhur, kufijtë e kompetencave, shtirjen e kompetencës së çdo administratori dhe nëse është e nevojshme, procedurat për mbledhjen e tyre.

Neni 14

Audituesit Ligjorë

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Ortaku i Vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe të regjistrave kontabël të Shoqërisë do t'i besohet një ose më shumë audituesve ligjore.

Neni 15

Viti Financiar dhe Pasqyrat Financiare

15.1 Viti ushtrimor financiar fillon në datën 1 Janar dhe përfundon në datën 31 Dhjetor të çdo viti.

15.2 Pasqyrat vjetore financiare, inventari dhe raporti i administratorit/ve dhe auditorit, nëse ka, miratohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me Ligjin për Shoqëritë e Tregtare.

Neni 16

Shpërbërja dhe Likuidimi i Shoqërisë

16.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me procedurën e likuidimit te saj, sipas dispozitave të Ligjit të Shoqërive Tregtare.

16.2 Procedura e likuidimit bëhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

16.3 Ortaku i Vetëm cakton një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar kompetencat e tyre në përputhje me ligjet në fuqi.

16.4 Shoqëria do të vazhdojë të ekzistojë si person juridik për qëllime të likuidimit deri në përfundimin e procedurës. Gjatë procedurës në fjalë, emërtimi i Shoqërisë do të shoqërohet nga fjalët "*në likuidim*".

Neni 17

Legjislacioni në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

17.1 Ky dokument bazohet në legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin shqiptar. Për çështjet që nuk rregullohen me këtë dokument do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

17.2 Në rast mosmarrëveshjesh që lindin ose kanë të bëjnë me interpretimin ose zbatimin e këtij dokumenti, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë është kompetente për të zgjidhur çdo pretendim ose mosmarrëveshje.

ORTAKE E VETME
KUMONETIC SHPK
Znj. Jona Bojdani

Jona Bojdani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MARGENA U. ÇELA

V20250531202454347S3

DATE 09/10/2025
NR REP 4116

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 09.10.2025 , para meje Noter MARGENA U. ÇELA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Astrit BALLUKU, u paraqit personalisht:

DEKLARUESJA: **Jona Bojdani**, atësia Jovan, amësia Teuta, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Sami Frashëri; Nd. 13; H. 10; Ap. 33; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 25/03/1998, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 039532111 dhe nr. personal J85325051U , .

Deklaruesja e mësipërmeJona Bojdani, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noterit, dokumentin:
AKT THEMELIM DHE STATUTI I "KUMONETIC" SHPK bashkëlidhur.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018*"Për Noterinë"*, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

MARGENA U. ÇELA